

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Metoda
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916643/zhulali-shteti-korporate-dhe-ekonomia-paralele-qe-p-o-nderton-kompani-pas-kompanie-edi-rama/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:30:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:09:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5da31e3222859aba257fcebfe49c28fb3f9e62a34a2e56a289c431f531562c9
TEKSTI	46b10dc0a2da3dfe580af9fb63e3491162d10cdbf67582042ce7ff5f9d829a28
PAMJA	0b1ff880d4a95237e1110f92dbff61d2c2930b58a1f4c6f4b69cd7c6f282aec7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6880a50ff72ab13317e620b37325bee363920f7dc01dc27997083cb69ef37f2c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6880a50ff72ab13317e620b37325bee363920f7dc01dc27997083cb69ef37f2c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën



më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia



Zhulali: Shteti-korporatë dhe ekonomia paralele, që po ndërton kompani pas kompanie Edi Rama

19:09, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Ilda Zhulali

Në maj 2026, raporti i SIGMA (programi i përbashkët OECD-BE për mbështetjen e qeverisjes), ngriti me shqetësim ndërtimin e rrjetit piramidal që ka ngritur Edi Rama në pothuajse të gjithë sektorët e qeverisjes, duke qendëruar rreth vetes 20 agjenci shtetërore.

Raporti vërente se agjencitë kanë funksione të mbivendosura ose të ngjashme me strukturat ministrore, administrojnë pjesë të konsiderueshme të buxhetit dhe punësojnë numër të madh nëpunësish. Kjo 'perandori agjencish' ishte skeleti origjinal, i asaj që do të ndodhte më vonë në formë tregtare. Tashmë Edi Rama po krijon kompani shtetërore që replikojnë logjikën e agjencive, por pa transparencë, kontroll financiar apo llogaridhënie.

Skandali i shpërthyer këto ditë me KAYO është dritarja që na lejon të shohim mekanizmin e plotë të një ekonomie paralele, që po ndërtohet kompani pas kompanie nën qeverinë Rama.

KAYO është prototipi, ose modeli bazë. Krijuar si shoqëri 100% shtetërore nën Ministrinë e Mbrojtjes, KAYO u krijua me qëllim 'modernizimin' e industrisë ushtarake. Në praktikë, funksionon si një kompani guaskë, pasi nuk prodhon asgjë vetë, por krijon gjashtë shoqëri të përbashkëta me privatë. Kontratat klasifikohen si 'strategjike' ose 'sekrete', duke shmangur çdo garë me prodhues të tjerë ndërkombëtarë.

Kështu, fondet e buxhetit të mbrojtjes kalojnë drejtpërdrejt te individë të përzgjedhur ekskluzivisht nga Rama, jashtë kontrollit të KLSH, jashtë kontrollit parlamentar dhe duke shmangur detyrimet ligjore të prokurimit publik. Paratë janë të buxhetit të shtetit, por përfitues është privati.

Korporata e Investimeve Shqiptare, funksionon me të njëjtën logjikë dhe skelet grabitqar, por zbatohet tek pasuritë e paluajtshme. Një shoqëri shtetërore që merr në pronësi çdo pronë publike (bregdet, troje qendrore e vendore) dhe e vë në dispozicion për 'investime'. Bordi mbikëqyrës ka vetëm 1 përfaqësues publik nga 5. Ndërsa prona publike bëhet asset i një zyre të vetme, jashtë vendimmarrjes apo kontrollit qoftë parlamentar qoftë vendor.

Albanian Digital Solution, e krijuar pikërisht pasi AKSHI u shpall subjekt i një skeme kriminale drejtuar nga një ekip nën akuzë si grup i strukturuar kriminal. ADS trashëgon të dhënat dixhitale të shtetit dhe infrastrukturën IT, por operon si biznes privat, duke caktuar vetë çmimet e shërbimeve për institucionet publike.

'Superkompania' e shëndetësisë, një projekt në zhvillim, ku një shoqëri 100% shtetërore do të monopolizojë të gjithë zinxhirin e furnizimit me barna e pajisje mjekësore për sistemin shëndetësor publik, që shmang tenderat e hapur. I njëjti model, i transferuar te shëndetësia.

Delvina Gas, vijon të njëjtin koncept, në një sektor tjetër. Sipas audiopërgjimit të publikuar prej Arben Ahmetajt, për fushën e gazit të Delvinës, flitet për një ndarje të paracaktuar aksionesh, ku privati do të zotëronte pjesën dërmuese dhe shteti do të mbante një pjesë të vogël, duke i shpëtuar kështu çdo kontrolli financiar dhe mbajtjeje përgjegjësie.

Pra në një kohë rekord, katër sektorë të ndryshëm, armatim, prona, teknologji, shëndetësi funksionojnë sipas të njëjtit skelet grabitqar:

1. Krijohet një agjenci ose kompani 'e nevojshme për modernizim', fillimisht me kapital '100% shtetëror', si mburojë ligjore.
2. Brenda saj hapen nën-shoqëri dhe bëhen partneritete/koncesione/marrëveshje me individë të zgjedhur, pothuajse të njëjtët emra që kalojnë nga sektori në sektor.
3. Kontratat klasifikohen si 'strategjike'/'konfidenciale' për të shmangur prokurimin e hapur.
4. Paratë merren 100% nga buxheti i shtetit (taksapaguesit shqiptarë).
5. KLSH dhe institucionet mbikëqyrëse mbeten jashtë auditimit.
6. Aseti publik (armë, tokë, të dhëna, barna) kthehet në burim fitimi privat, pa asnjë investim nga ky i fundit.

Përmes kësaj ekonomie paralele, Shqipëria po qeveriset gjithnjë e më pak si republikë dhe gjithnjë e më shumë si një korporatë, me Edi Ramën si të vetmin aksioner real. Çdo kompani e re shtetërore që lind, qoftë kjo KAYO, KISH, ADS, Delvina Gas, 'superkompania' e shëndetësisë, apo tjetër është thjesht një degë e së njëjtës firmë. Dhe si çdo korporatë, ajo nuk ka nevojë t'i japë llogari askujt tjetër përveç atij që e themeloi.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Territorialja'/ Divjaka kundër bashkimit me Lushnjën. Gati relacioni për në Kuvend



Protesta e 107-të/ Nis marshimi drejt Kryeministrit, protestuesit: Rama jep dorëheqjen!



Bardhi: Nëse Veliaj del nga burgu, me vendim të GJL, ky do të jetë funerali përfundimtar i Reformës në Drejtësi

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

TË NGJASHME



Kurti pret në takim shefin e ri të Zyrës së BE-së në Kosovë



Trafiku i armëve, Kalaja: Fakti që Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s, e bën këtë skandal akoma më të rëndë



Skandali - 'Paratë dhe asetet janë të shtetit'/ Bozdo: Miliardat e mbrojtjes do të kalojnë përmes KAYO-s



Balliu publikon videon: Shikoni si merren zvarrë, dhunohen dhe goditen me grushta protestuesit nga policia e pushtetit



VIDEO/ Çollaku: Kemi dhe 'Timak China', qeveria karrigen në NATO paradite e mban vetë, pasdite ua jep kinezëve



Heshtja e elitave përballë çmendurisë: harrohen çamëria e kosova, ndërtohet muze për hebrenjtë dhe shtet bektashi



Kërcënimi me vdekje ndaj gazetarit Stafës, terror shtetëror! Blushi: Përgjegjësia është e Edi Ramës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.